

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Zoti ministër, qeveria, e cila është në mandatin e tretë, ka propaganduar si aksione të një rëndësie të veçantë për Shqipërinë dy nisma, të cilat i kemi debatuar dhe i kemi diskutuar edhe në këtë sallë, si nisma më shumë propagandistike, por edhe nisma, të cilat të bëheshin për një arsye të caktuar. Nisma e parë ishte për të vendosur gjoba ndaj subjekteve kriminale, e dyta, për t'i përfshirë ata në fushatën e Partisë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit. E njëjta gjë ishte edhe me propozimin për vetingun në polici, ku kërkohet të intimidohet një kontingjent i madh për t'i përfshirë edhe ata dhe për t'i kërcënuar që të përfshihen në fushatën e Partisë Socialiste.

Kontrolli i subjekteve kriminale të dënuar brenda apo jashtë territorit të Shqipërisë është miratuar në Kuvend me aktin normativ nr. 1, datë 31.01.2022 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike", i ashtuquajtur apo i njohur në publik si Operacioni Forca e Ligjit. Propagandimi mediatik dhe daljet e shpeshta para fushatës së 25 prillit 2021 pasuan me një vakuum dhe heshtje pas zgjedhjeve, gjë që lë dyshime të arsyeshme se ky operacion u krye për të intimiduar kontingjentin kriminal për t'u përfshirë në fushatën zgjedhore të partisë në pushtet.

Ja çfarë deklaronte Kryeministri për dy prej nismave më të rëndësishme, sipas tij, në fushën e rendit dhe sigurisë publike (Edi Rama i dytë për vetingun e policisë): "Pastërtia e radhëve të policisë dhe integriteti i lartë është parakusht i domosdoshëm dhe i padiskutueshëm. Ne kemi bërë sa kemi mundur, jo sa kemi dashur në funksion të rritjes së shpërblimit moral e financiar për punonjësit e policisë dhe do të vazhdojmë të bëjmë edhe më shumë, por procesi historik i pastrimit të Policisë së Shtetit, sikurse edhe të gjyqësorit, nga elementë të kriminalizuar, të

korruptuar, por edhe të paaftë do të vijojë me vendosmëri në radhët e Policisë së Shtetit, pastaj të gjitha strukturave të tjera ligjzbatuese.

Vetingu, që është organizuar e do të fillojë në Policinë e Shtetit nga janari, do të japë rezultate të qenësishme. Po ashtu, kam besim se brezat që do të dalin, duke nisur së shpejti nga Akademia e Policisë, do të jenë një burim i jashtëzakonshëm transformimi i gjakut të Policisë së Shtetit.” Kryeministri Edi Rama kur foli para punonjësve të Policisë së Shtetit, u shpreh: “Specialistë të FBI-së do të vijnë në vendin tonë për ta ndihmuar policinë në luftën e saj kundër krimit”. Por para kësaj Rama tha: “Duhet të bëhet vetingu i policisë, pasi vetëm me një polici të pastër do të ketë një luftë reale dhe një goditje finale ndaj krimit dhe drogës në këtë vend”. Nëse ndjekim logjikën e Ramës, pra, nëse procesi i vetingut në polici ka dështuar, prandaj mund të ketë marrë dhenë edhe gjendja e kriminalitetit anembanë vendit?

Sipas tij, FBI-ja do të jetë ishte ajo që do të bënte vetingun e Policisë së Shtetit, kur, veç të tjerave, do të përdorej edhe poligrafi për të bërë testin e sinqeritetit për punonjësit e Policisë së Shtetit. Ndërkohë, për Operacionin Forca e Ligjit Edi Rama trumbetonte: “Duhet t’ua bëjmë të paretshëm atdheun atyre që janë subjektet e këtij ligji special. Atdheu për ta nuk mund të jetë sheshi për të bërë përshesh; nuk mund të jetë rruga për të ekspozuar mjetet e tyre luksoze motorike; nuk mund të jetë sheshi i ndërtimit për vilat dhe bizneset e tyre që nuk burojnë nga puna, por burojnë edhe nga gjaku i komisarëve dhe i policëve të vrarë në këta 30 vjet; nuk mund të jetë platforma e ekspozimit të muskujve në klubet dhe në hapësirat e tjera publike, ku të rinjtë, familjet mbledhen me të drejtën e tyre për të kaluar orë së bashku pas pune, por duhet të jetë ferri i tyre”.

Sipas tij: “Një kohë ekstreme, kërkon masa ekstreme”. Po çfarë parashikonte ky ligj dhe ku jemi sot? Në mënyrë të përmbledhur, për ta kuptuar se sa ia ka dalë qeveria ta realizojë: - Ky akt normativ ka qenë një nismë për të pastruar me letra pasurinë e grupeve kriminale? - Nëse ka pasur luftë ndaj tyre, pse Shqipëria edhe sot renditet në listën gri për pastrimin e parave dhe nga viti në vit përkeqësohet? - Cilat para pastrohen realisht në Shqipëri, nëse nuk janë këto para të këtyre grupeve, që në një pjesë të madhe janë pjesë e OFL-së? - A janë realizuar

qëllimet e aktit? Në ministri kam dërguar një shkresë për të ditur: sa është numri total i subjekteve të trajtuara dhe të hetuara nga OFL-ja?

Sa është numri i subjekteve të OFL-së, që ende nuk janë referuar në SPAK? Cila është lista e plotë e subjekteve të referuara në SPAK dhe lista e subjekteve që nuk janë referuar, që të kemi mundësi t'ua bëjmë me dije qytetarëve? A ka selektivitet? A ka ndërhyrje politike? A ka njerëz, të cilët janë favorizuar nga ky ligj? A kemi dy standarde në zbatimin e këtij akti normativ? Sa prej këtyre rasteve të referuara pranë Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë kthyer nga ky organ për plotësim dokumentacioni në strukturën e policisë? Sa është numri total, nga ana tjetër, për pjesën tjetër të nismave të qeverisë, i punonjësve të policisë që janë vetuar? Besoj se këto janë pyetje që ministri do t'u përgjigjet.

Sa prej tyre e kanë kaluar vetingun? Sa punonjës të Policisë së Shtetit priten të kalojnë në veting dhe në cilën periudhë, apo është një nismë, e cila ka dështuar dhe ende nuk është thënë? Këto janë pyetjet që i kam drejtuar ministrit. Pa diskutim pyetjet që ngre edhe publiku janë: a është arritur të realizohet qëllimi që ka pasur ky ligj, si: bllokimi i pasurisë, izolimi fizik dhe heqja e të drejtës për të marrë para publike në çfarëdolloj forme? Po dëgjojmë edhe nga këto hatatë, ku një prej kriminelëve të kapur nga SPAK-u, është një prej personave që kryejnë edhe vrasje me pagesë, që janë përfshirë në trafik droge, që janë përfshirë në struktura të krimit të organizuar nëpërmjet familjarëve të tyre, bashkëshorteve apo edhe drejtpërdrejt, kanë marrë para publike dhe tenderë me miliona euro.

Rastet e fundit e tregojnë këtë, po ashtu, për fat të keq, edhe dje, tregojnë edhe degradimin. Për shkak të moszbatimit të ligjit dhe mospasjes vullnet nga ana e qeverisë për të luftuar krimin dhe korrupsionin, jemi në këtë gjendje ku jemi të kriminalitetit, ku në çdo moment dëgjojmë për vrasje, për atentate, për tritol, për kapjen të sasive të mëdha të drogës. A e kanë depozituar që të gjitha subjektet e këtij ligji deklarimin e tyre pranë OFL-së ku duhet të depozitohej brenda 48-orësh? A kanë ata apo familjarët e tyre dhe çdo person i dyshuar për lidhjet me to burime të ligjshme të sigurimit të pasurive? A ka deputetë dhe ish-deputetë, ish-kryetarë bashkie apo edhe ish-ministra, të cilët janë subjekt klasik i këtij ligji dhe ju i keni favorizuar duke mos i çuar në Strukturën e Posaçme Antikorrupsion? Faleminderit!